

VENDIM
Nr. 427, datë 26.6.2019

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE PËR
PËRFSHIRJEN E KUALIFIKIMEVE PËR TË NXËNIT GJATË GJITHË JETËS,
SIPAS NIVELEVE TË KORNIZËS SHQIPTARE TË KUALIFIKIMEVE, PËR
ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të nenit 6, të ligjit nr. 10247, datë 4.3.2010, “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të ministrit të Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i nivelit të kualifikimeve për të nxënësit gjatë gjithë jetës, me qëllim përfshirjen e tyre në nivelet përkatëse të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (në vijim, KSHK), për arsimin dhe formimin profesional, në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në këtë vendim.

2. Objekt i këtij vendimi janë kualifikimet për të nxënësit gjatë gjithë jetës, që ofrohen me jo më pak se 125 (njëqind e njëzet e pesë) orë ose 5 (pesë) kredite ECTS (për kualifikime të arsimit të lartë).

3. Të gjitha kualifikimet për të nxënësit gjatë gjithë jetës, sipas përcaktimeve në shtojcën nr.1, të ligjit për KSHK-në, për të cilat kërkohet nga ofruesi përcaktimi në diplomën/certifikatën përkatëse të nivelit të kualifikimit, sipas niveleve të KSHK-së, plotësojnë kriteret dhe procedurat e parashikuara në këtë vendim për përfshirjen e tyre në nivelin përkatës të KSHK-së.

4. Këtyre kualifikimeve u caktohet niveli i KSHK-së si rezultat i krahasimit të rezultateve të deklaruara të të nxënësit për kualifikimin e dhënë me përshkruesit e detajuar të niveleve të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, sipas përcaktimeve në këtë vendim.

KREU II
KRITERET PËR PËRFSHIRJEN E KUALIFIKIMEVE SIPAS NIVELEVE
PËRKATËSE TË KSHK-SË

1. Vendimarrja, që rezulton pas një procesi të vlerësimit të rezultateve të të nxënësit të kualifikimit me përshkruesit e niveleve të KSHK-së, për përfshirjen e kualifikimeve, objekt i këtij vendimi në KSHK, duke përcaktuar nivelin e kualifikimit nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe/ose ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, sipas fushës së përgjegjësisë, bazohet në plotësimin e kriterëve, si më poshtë vijon:

- a) Të ketë të përcaktuar qartë titullin e kualifikimit;
- b) Ofruesi i kualifikimit të jetë i licencuar, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, nga autoriteti që mbulon fushën përkatëse të përgjegjësisë për të ofruar këtë lloj kualifikimi, si dhe të

¹ Ky vendim është përafruar pjesërisht me:

Rekomandimin e Këshillit të Evropës (2017 / C 189/03), datë 22 maj 2017, “Mbi Kornizën Evropiane të Kualifikimeve për të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe shfuqizimin e rekomandimit të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 23 prillit 2008, për themelimin e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve për të nxënësit gjatë gjithë jetës”.

jetë i autorizuar për të ofruar kualifikimin për të cilin kërkohet përfshirja e kualifikimit sipas nivelit të KSHK-së, para fillimit të ofrimit të kualifikimit;

c) Të jetë përcaktuar numri total i krediteve (ku aplikohet)/ngarkesa mësimore në orë, si dhe kohëzgjatja e kualifikimit;

ç) Të jetë arsyetuar me të dhëna faktike nevoja e kualifikimit në tregun e punës;

d) Kualifikimi të bazohet në rezultatet e të nxënit;

dh) Kualifikimi të ketë qëllime dhe objektiva të qarta, të ofrojë mundësi për progres, si dhe të ketë mbështetje nga grupet e interesit;

e) Niveli i propozuar i kualifikimit në KSHK të përcaktohet në mënyrë të qartë sipas përshkruesve të detajuar të niveleve të KSHK-së dhe të shoqërohet me arsyetimin përkatës, i cili argumenton arsyen e pozicionimit të këtij kualifikimi në nivelin e propozuar, vlerësimin e rëndësisë së kualifikimit dhe njohjes së tij brenda sektorit përkatës të kualifikimit, prezantimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave më të gjera, sipas përshkruesve përkatës të detajuar të niveleve të KSHK-së;

ë) Kërkesat për nivelin minimal hyrës të kualifikimit, në një kualifikim të caktuar për të nxënit gjatë gjithë jetës, të jenë të qarta dhe t'u referohen përcaktimeve në shtojcën nr.1, të ligjit të KSHK-së.

f) Në rastin e kualifikimeve të ofruara në zbatim të ligjit për arsimin dhe formimin profesional (në vijim, AFP), përshkrimi i kualifikimeve të jetë i bazuar në përshkruesit/standardet e profesioneve përkatëse;

g) Të ketë kritere të qarta të vlerësimit të arritjeve të individit në fund të kualifikimit për të nxënit gjatë gjithë jetës;

gj) Dokumenti i lëshuar nga ofruesi që certifikon zotërimin e kualifikimit përkatës lëshohet vetëm pas arritjes së një rezultati pozitiv në vlerësimin e rezultateve të kërkuara të të nxënit (vlerësimit), të përcaktuara e të miratuara për kualifikimin përkatës dhe që përputhen me nivelin e KSHK-së, miratuar për këtë kualifikim sipas përcaktimeve të këtij vendimi. Ai duhet të cilësojë në mënyrë të qartë që i referohet një kualifikimi për të nxënit gjatë gjithë jetës;

h) Të plotësojë kushtet e nevojshme për ofrimin e kualifikimit respektiv në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit që mbulon fushën përkatëse të përgjegjësisë dhe të ketë kaluar me sukses procesin e sigurimit të jashtëm të cilësisë.

KREU III OFRUESIT DHE DOKUMENTACIONI

1. Kualifikimet për të nxënit gjatë gjithë jetës që përfshihen në KSHK ofrohen vetëm nga institucionet e licencuara/të aprovuara dhe të akredituara për këtë qëllim.

2. Ofruese janë të gjitha ato subjekte juridike, publike e jopublike, të cilat kanë të parashikuar, në objektin e tyre të veprimtarisë, ofrimin e kualifikimeve për të nxënit gjatë gjithë jetës, si dhe plotësojnë kriteret e parashikuara për këtë qëllim, në përputhje me këtë vendim dhe akte të tjera, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

3. Ministri përgjegjës për arsimin dhe ministri përgjegjës për arsimin e formimin profesional janë përgjegjës për mbikëqyrjen e ofrimit të kualifikimeve dhe sigurimin e cilësisë, sipas fushave respektive të përgjegjësisë. Nëse ngrihen dyshime për parregullsi lidhur me kriteret apo procedurat e ofrimit të kualifikimeve nga ofruesi, ministri përgjegjës urdhëron strukturat përkatëse të ministrisë dhe/ose agjencinë/entin akreditues, në varësi të parregullsive të vërejtura, të realizojë një verifikim *ad hoc* të ofruesit.

4. Ministri përgjegjës për arsimin dhe ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional përcaktojnë me udhëzim të përbashkët procedurat e inspektimit, me qëllim garantimin e paanshmërisë në procesin e inspektimit. Raporti i inspektimit përfshin, veç të tjerave, edhe një përshkrim të fakteve të vërtetuara, duke përfshirë parregullsitë e gjetura, qëllimin, shkaqet dhe

efektet e tyre, së bashku me emrat e funksionet e atyre që janë përgjegjës për shkaktimin e tyre dhe rekomandimet për veprime korrigjuese.

5. Aplikanti paraqet dokumentacionin ligjor, si më poshtë vijon:

a) Kopje të ekstraktit historik të subjektit nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), e cila të parashikojë në objektin e veprimtarisë ofrimin e kualifikimeve për të nxënit gjatë gjithë jetës;

b) Dokument të licencimit/autorizimit të ofruesit për të operuar në ofrimin e kualifikimeve për të nxënit gjatë gjithë jetës, si dhe licencë për të ofruar këtë lloj kualifikimi, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, lëshuar nga autoriteti që mbulon fushën përkatëse të përgjegjësisë;

c) Vërtetime (për administratorin/administratorët dhe shoqërinë), që certifikojnë se subjekti nuk është në ndjekje penale nga organi i prokurorisë;

ç) Vetëdeklarim ose dëshmi penaliteti për administratorin/administratorët;

d) Të dhëna për burimet financiare, shoqëruar me dokument bankar që shpreh vlerën e burimeve financiare që subjekti juridik zotëron, si dhe burimet materiale, bibliotekare dhe informatike të nevojshme për programet e reja të studimit;

dh) Adresë e subjektit, adresë elektronike dhe numër telefoni.

6. Përshkrimi i kualifikimit dhe përshkruesit e profesionit me të cilin lidhet ky kualifikim në rastin e AFP-së e në rastet e tjera ku parashikohet, përfshijnë:

a) titullin e kualifikimit;

b) argumentimin e nevojës për kualifikim në kontekstin e tendencave në tregun e punës, zhvillimin e teknologjive të reja dhe nevojave sociale;

c) emërtimin e dokumentit që lëshohet në përfundim të tij dhe vlefshmërinë;

ç) modelin e diplomës/certifikatës që do t'i lëshohet individit që ka përfunduar me sukses kualifikimin nga ofruesi;

d) në rast se parashikohet që kualifikimi për të nxënit gjatë gjithë jetës ofrohet përmes një programi studimi të përbashkët me institucione të tjera vendase apo të huaja, paraqitet një dokument zyrtar bashkëpunimi, si dhe dokumenti zyrtar i akreditimit të institucionit bashkëpunues, nëse ka;

dh) përshkrimin e përgjithshëm e të detajuar të kualifikimit, duke përfshirë të dhëna për planin mësimor dhe tërësinë e rezultateve të të nxënit në njohuri, aftësi dhe kompetenca më të gjera, që duhen arritur në përfundim të kualifikimit, objektivat e qëllimet e shprehura qartë, sipas përshkruesve të detajuar të niveleve të KSHK-së, mundësitë për progres të mëtejshëm, mbështetjen nga grupet e interesit, kriteret e vlerësimit të arritjeve të individit në përfundim të kualifikimit etj.;

e) ngarkesën e përafërt mësimore, të përcaktuar në orë e kredite ECTS (në rastin e kualifikimeve të ofruara në sistemin e arsimit të lartë), të nevojshme për të marrë kualifikimin;

ë) kërkesat për pranimin e individit në kualifikimin përkatës, në veçanti niveli i arsimit të kërkuar, referuar përcaktimeve në shtojcën 1 të ligjit për KSHK-në;

f) në rastin e AFP-së dhe në rastet e tjera ku parashikohet, përshkrimin e profesionit, duke përfshirë kodin përkatës të listës kombëtare të profesioneve, si dhe një listë të detajuar të funksioneve/detyrave dhe informacione të tjera të nevojshme që lidhen me profesionin;

g) mundësitë tipike të përdorimit të kualifikimit;

gj) rregulloren e funksionimit të programit përkatës të kualifikimit;

h) propozimin e nivelit të KSHK-së, duke përfshirë arsyetimin përkatës, i cili argumenton arsyen e pozicionimit të këtij kualifikimi në nivelin e propozuar, vlerësimin e rëndësisë së kualifikimit dhe të njohjes së tij brenda sektorit përkatës të kualifikimit, korrespondencën e njohurive, aftësive dhe të kompetencave më të gjera të deklaruara;

i) fushën respektive të kualifikimit sipas ISCED 2013-F;

j) Kopjen e mandatit të pagesës;

Për kualifikimet për të nxënit gjatë gjithë jetës, që parashikohen në nivelet 5-8 në fushën e arsimit të lartë, dokumenti që provon akreditimin e ofruesit dhe të programit përkatës të

kualifikimit dorëzohet përpara përfundimit të procedurave për përfshirjen e kualifikimeve sipas niveleve të KSHK-së, për arsimin dhe formimin profesional.

KREU IV INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE DHE PROCEDURAT QË NDIQEN NGA OFRUESIT

1. Institucionet përgjegjëse për përcaktimin e niveleve të KSHK-së për kualifikimin përkatës përmes procesit të verifikimit të rezultateve të të nxënimit me përshtatësit e niveleve janë:

- a) Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve;
- b) Ministria përgjegjëse për arsimin për nënsektorin e arsimit të lartë dhe arsimin e përgjithshëm.

2. Institucionet përgjegjëse për ndjekjen e procedurave për përcaktimin e nivelit të KSHK-së për kualifikimin përkatës janë, si më poshtë vijon:

- a) Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) për nënsektorin e arsimit dhe formimit profesional;
- b) Qendra e Shërbimeve Arsimore për nënsektorin e arsimit të lartë dhe arsimin e përgjithshëm.

3. Për përfshirjen e kualifikimeve për të nxënimit gjatë gjithë jetës në KSHK ngrihet komisioni për përfshirjen e kualifikimeve, objekt i këtij vendimi, nga institucionet përgjegjëse për secilin nënsektor të KSHK-së.

4. Komisioni asistohet nga sekretariati teknik me anëtarë nga institucionet përgjegjëse për ndjekjen e procedurave.

5. Institucionet përgjegjëse për përcaktimin e nivelit të KSHK-së bashkëpunojnë për përgatitjen e rregullores përkatëse për funksionimin e komisionit e të aplikimit dhe u propozojnë ministrave përgjegjës për arsimin dhe arsimin e formimin profesional draft-rregulloren për miratim. Rregullorja miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin dhe të ministrit përgjegjës për arsimin e formimin profesional, jo më vonë se 1 (një) vit nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

6. Aplikimi për të përfshirë kualifikimet e të nxënimit gjatë gjithë jetës në KSHK, për të përcaktuar nivelin përkatës, bëhet me anë të një kërkesë drejtuar institucioneve përgjegjëse për këtë qëllim, sipas këtij vendimi, e cila shoqërohet me dokumentacionin e parashikuar në këtë vendim.

7. Komisioni, pasi merr në shqyrtim informacionin e përcjellë nga aplikanti, kthen përgjigje brenda 1 (një) muaji, për përfshirjen e kualifikimit, objekt i këtij vendimi në KSHK, refuzimin e kërkesës apo plotësimin e dokumentacionit. Pas kërkesës për plotësim dokumentacioni, nëse dokumentacioni rezulton sërish i paplotë, praktika arkivohet dhe aplikanti riaplikon sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

8. Komisioni shprehet me vendim në rastet e vendimmarrjes për pranimin, refuzimin e kërkesës apo arkivimin e praktikës. Institucionet përgjegjëse për ndjekjen e procedurave, sipas këtij vendimi, përgatisin vërtetimin për përcaktimin e nivelit përkatës të KSHK-së për çdo aplikim. Në çdo rast njoftohet aplikuesi dhe, në rast të refuzimit të kërkesës, i jepen edhe arsyet përkatëse.

9. Niveli i miratuar i kualifikimit dhe numri e lloji i krediteve të fituara (kur këto janë të miratuara) vendosen në dokumentin vërtetues që do të lëshohet në përfundim të kualifikimit, duke specifikuar llojin e kualifikimit sipas shtojcës nr. 1 të ligjit për KSHK-në.

10. Kualifikimet për të nxënimit gjatë gjithë jetës, së cilave i është përcaktuar niveli sipas KSHK-së, përfshihen në regjistrin kombëtar për kualifikimet për të nxënimit gjatë gjithë jetës, i cili hartohet, administrohet e mirëmbahet, sipas fushës së përgjegjësisë, nga institucionet respektive përgjegjëse. Nëse kualifikimet, objekt i këtij vendimi, nuk ofrohen për një periudhë 4-vjeçare nga momenti i përcaktimit të nivelit të KSHK-së, ato hiqen nga regjistri kombëtar i sipërcituar. Për

kualifikimet, objekt i këtij vendimi, për të cilat kryhen ndryshime të kriterëve të deklaruara në momentin e përcaktimit të nivelit të KSHK-së, ofruesi aplikon, jo më vonë se 1 (një) muaj nga ndryshimi i kriterëve, për ripërcaktimin e nivelit sipas KSHK-së, sipas parashikimeve të këtij vendimi, duke përcjellë ndryshimet, përfshirë dokumentacionin e arsyetimin përkatës justifikues. Në rast të kundërt, kualifikimi i ofruar nga ky ofrues hiqet nga regjistri kombëtar.

11. Kualifikimet për të nxënit gjatë gjithë jetës, së cilave i është përcaktuar niveli sipas KSHK-së dhe janë bërë pjesë e regjistrit kombëtar sipas ofertuesve, hiqen nga ky regjistër, përveç sa është parashikuar më sipër dhe në këto raste:

a) Vlerësim negativ në procesin e sigurimit të cilësisë. Në këtë rast, institucioni/enti përgjegjës për sigurimin e jashtëm të cilësisë njofton institucionet përgjegjëse, sipas fushës përkatëse të përgjegjësisë, për të ndjekur procedurat për heqjen e kualifikimit nga regjistri kombëtar i kualifikimeve;

b) Ofruesi lëshon diploma/certifikata për persona, të cilët nuk janë vlerësuar pozitivisht;

c) Vërehen parregullsi në ofrimin e kualifikimit në vijim të një inspektimi ose vlerësimi të jashtëm;

d) Ofruesi nuk ka marrë masa korrigjuese pavarësisht rekomandimeve të dhëna;

e) Ofruesi nuk plotëson më kushtet e parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi për ofrimin e kualifikimeve dhe ushtrimin e aktivitetit.

12. Procedura për përfshirjen e kualifikimeve për të nxënit gjatë gjithë jetës në KSHK nuk zgjat më shumë se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së kërkesës së aplikantit.

KREU V

NJOHJA E KREDITEVE/REZULTATEVE TË TË NXËNIT DHE SIGURIMI I CILËSISË

1. Kreditet ECTS të përfituara përmes kualifikimeve për të nxënit gjatë gjithë jetës, së cilave i është përcaktuar niveli i KSHK-së, njihen në kuadër të kualifikimeve të ngjashme të të nxënit gjatë gjithë jetës të të njëjtit nivel të KSHK-së apo në kuadër të programeve të studimit të arsimit të lartë të të njëjtit nivel të KSHK-së.

2. Rezultatet e të nxënit të përfituara përmes kualifikimeve për të nxënit gjatë gjithë jetës, së cilave i është përcaktuar niveli i KSHK-së e që nuk ofrohen me kredite ECTS, njihen në kuadër të kualifikimeve të ngjashme për të nxënit gjatë gjithë jetës të të njëjtit nivel të KSHK-së apo në kuadër të kualifikimeve të tjera të të njëjtit nivel të KSHK-së, të cilat nuk ofrohen me ECTS.

3. Njohja, sipas përcaktimeve të pikave të sipërcituara, bëhet mbi bazën e vlerësimit të rezultateve të të nxënit me programin e studimit për të cilin kërkohet të bëhet njohja.

4. Ofruesi përfundon procesin e sigurimit të cilësisë përpara lëshimit të diplomave/certifikatave të kualifikimit përkatës, i cili parashikon sigurimin e brendshëm e të jashtëm të cilësisë, në përputhje me standardet evropiane të cilësisë të arsimit të lartë (*Standards and Guidelines for Quality Assurance in the European Higher Education Area - European Standards and Guidelines, ESG*), standardet e sigurimit të cilësisë në arsimin dhe formimin profesional (*European Quality Assurance in Vocational Education and Training, EQAVET*) dhe linjat guidë për vlerësimin (*European Guidelines for validating non-formal and informal learning (CEDEFOP 2009)*).

5. Sigurimi i brendshëm i cilësisë nga ofruesi kryhet përmes sistemit të brendshëm të ngritur të sigurimit të cilësisë, që përcakton qartë rregullat e operimit, procedurat, metodologjinë dhe organizimin e këtij sistemi. Qëllimi i sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë në institucionin ofrues është të sigurojë që vlerësimi e certifikimi kryhen siç duhet dhe se ato përmirësohen në vazhdimësi.

6. Sistemi i sigurimit të jashtëm të cilësisë monitoron e vlerëson në mënyrë periodike aktivitetet që lidhen me lëshimin e dokumentit që certifikon zotërimin e kualifikimit dhe kryhet nga një autoritet/ent i jashtëm nga ai ofrues, në përputhje me përcaktimet në kuadrin ligjor në

fuqi. Ky autoritet/ent vlerëson ofrimin e kualifikimit sipas standardeve përkatëse dhe asiston ofruesin në përmirësimin e proceseve të vlerësimit e të certifikimit.

7. Në procesin e sigurimit të jashtëm të cilësisë së kualifikimeve të arsimit të lartë mund të angazhohen enti/agjencia publike përkatëse e ngarkuar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë, sipas nivelit e llojit të kualifikimit ose ente/agjenci publike homologe të huaja të regjistruara në EQAR. Ministri përgjegjës për arsimin e ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional përcaktojnë me urdhër të përbashkët listën e enteve të huaja të autorizuar për këtë qëllim, sipas fushës së përgjegjësisë.

8. Sigurimi i jashtëm i cilësisë për kualifikimet për të nxënëit gjatë gjithë jetës në fushën e arsimit të lartë duhet të mbajë parasysh, si më poshtë vijon:

- a) Akreditimi i programit të studimit duhet të përfshijë, veç të tjerave, dhe:
 - i. vlerësimin e kongruencës së rezultateve të të nxënëit të kualifikimit të ofruar me përshkruesit përkatës të niveleve të KSHK-së;
 - ii. aftësinë për të arritur këto rezultate të të nxënëit, duke pasur parasysh kushtet ku ofrohet programi;
 - iii. përshtatshmërinë e vlerësimit (validimit) të rezultateve të të nxënëit.
- b) Akreditimi institucional duhet të konsiderojë, veç të tjerave, dhe:
 - i. funksionimin e përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë;
 - ii. akreditimet e certifikimet e marra nga institucione ndërkombëtare nga ofruesi ose strukturat përbërëse të tij;
 - iii. rezultatet e akreditimit të mëparshëm të programeve.

9. Sigurimi i jashtëm i cilësisë duhet të marrë në konsideratë, veç të tjerave, dhe respektimin e detyrimeve ligjore nga ana e ofruesit, si dhe të respektimit të kriterëve e të dokumentacionit të parashikuar në momentin e licencimit.

10. Për kualifikimet, të cilat shprehin dhe numrin e krediteve ECTS, për akreditimin e kualifikimit e të ofruesit, aplikohen gjithashtu dhe kriteret e standardet e cilësisë të parashikuara për programet e studimit dhe institucionet e arsimit të lartë. Me përfundimin me sukses të procedurave për akreditimin dhe përcaktimin e nivelit sipas KSHK-së, ofruesi parashikon në diplomë/certifikatë dhe numrin e krediteve ECTS e të dhënat për vendimin përkatës të akreditimit.

11. Sigurimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë për kualifikimet për të nxënëit gjatë gjithë jetës për nivelet 2-5 të KSHK-së, në fushën e përgjegjësisë së arsimit dhe të formimit profesional, kryhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.

12. Vlerësimi i jashtëm i cilësisë është i detyrueshëm dhe periodik.

13. Ministri përgjegjës për arsimin ose ministri përgjegjës për arsimin e formimin profesional, sipas fushës përkatëse të përgjegjësisë, kryejnë verifikime të agjencisë/entit akreditues lidhur me zbatimin e detyrimeve që lidhen me procesin e sigurimit të jashtëm të cilësisë. Në rast të evidentimit të parregullsive, i kërkohet agjencisë/entit akreditues të korrigjojë parregullsitë ose procedohet me heqjen nga lista përkatëse.

14. Ofruesit derdhin tarifat si më poshtë në llogarinë e institucioneve përgjegjëse, të përcaktuara sipas këtij vendimi, për trajtimin e kërkesave të ofruesve për përfshirjen e kualifikimeve, objekt i këtij vendimi, në KSHK:

a) Tarifa për trajtimin, shqyrtimin e kërkesës dhe përfshirjen e kualifikimit, objekt i këtij vendimi në KSHK, është 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për kualifikimet me kohëzgjatje deri në 6 (gjashtë) muaj/30 (tridhjetë) kredite ECTS dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë për kualifikimet me kohëzgjatje mbi 6 (gjashtë) muaj/30 (tridhjetë) kredite ECTS;

b) Ofruesit i paguajnë një tarifë vjetore, prej 3% të të ardhurave që sigurohen nga tarifat e aplikuara për kualifikimet për të nxënëit gjatë gjithë jetës, institucionit përgjegjës për ndjekjen e procedurave për përcaktimin e nivelit, sipas KSHK-së, për të mundësuar trajtimin e çështjeve të

ndryshme që kanë lidhje me vlerësimin periodik, shërbimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit kombëtar të kualifikimeve për të nxënit gjatë gjithë jetës dhe të programit të aplikimit *on-line*.

15. Tarifa për trajtimin dhe shqyrtimin e kërkesës për përfshirjen e ofruesve në listën e ofruesve të certifikuar për ofrimin e kualifikimeve për të nxënit gjatë gjithë jetës dhe sigurimin e cilësisë miratohen më urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe të ministrit përgjegjës për financat.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

1. Për kualifikimet për të nxënit gjatë gjithë jetës, të ofruara si kurse të unifikuara të formimit profesional nga subjektet publike në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, përmbajtja e të cilave zhvillohet nga AKAFPK-ja, bazuar në një cikël të brendshëm të sigurimit të cilësisë, paraqitet vetëm dokumentacioni i parashikuar në këtë vendim e përjashtohen nga tarifat.

2. Ministrinë përgjegjëse për menaxhimin e KSHK-së, sipas fushës së përgjegjësisë, jo më vonë se 1 (një) vit nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, përshtatin kuadrin ligjor në fuqi për licencimin dhe akreditimin e ofruesve dhe të kualifikimeve, me kriteret dhe procedurat përkatëse për të licencuar/aprovuar e akredituar institucionet ofruese dhe kualifikimet, objekt i këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe ofruesit e kualifikimeve për të nxënit gjatë gjithë jetës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe